



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E ANALIZAVE DHE PROGRAMIMIT BUXHETOR

Nr. 3514/2 Prot.

Tiranë, më 27/2/2026

Lënda: Dërgohet udhëzimi vjetor i përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2027-2029

Ministrisë _____

Institucionit Qendror _____

Bashkëngjitur gjeni udhëzimin vjetor nr., datë 27.2.2026 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029”.

Me respekt,

MINISTRI

PETRIT MALAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

MINISTRIA E FINANCEVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E ANALIZAVE DHE PROGRAMIMIT BUXHETOR

3514/1

U D H Ë Z I M

27.2.2026

Nr. 6 Datë 27.2.2026

“PËR
PËRGATITJEN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2027-2029”

Në përputhje me nenet 4 dhe 24 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe pikës 8, të çështjes 3.1 të Udhëzimit nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, ministri i Financave;

U D H Ë Z O N:

1. Programi Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 do të përgatitet sipas metodologjisë së miratuar në detaje në udhëzimin standard të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm nr.7, datë 28.02.2018, i ndryshuar, që mund të shkarkohet në linkun: <https://financa.gov.al/udhezime-standarde-per-pergatitjen-e-buxhetit-2/>
2. Tavanet përgatitore të shpenzimeve buxhetore për përgatitjen e PBA 2027-2029, në nivel programi dhe grup shpenzime buxhetore do të përcillen në një moment të dytë.
3. Kërkesat buxhetore, në këtë fazë, do të klasifikohen dhe paraqiten në kërkesa për financimin e politikave ekzistuese dhe kërkesa për financimin e politikave të reja. Metodologjia për kostimin e politikave ekzistuese dhe politikave të reja është e përcaktuar në udhëzimin standard të përgatitjes së PBA. Kjo metodologji kërkon që:
 - Kostimi të fillojë nga politikat ekzistuese dhe të vijojë me politikat e reja.
 - Tavanet indikative pjesë e këtij udhëzimi, të hartuara bazuar në historikun e shpenzimeve të programit, duhet të përfshijnë së pari koston e politikave ekzistuese. Nuk përjashtohet rasti që brenda tavanit indikativ të programit të parashikohet financimi i politikave të reja.

- Kostoja për financimin e politikave ekzistuese për njësinë e qeverisjes qendrore në kuadrin afatmesëm përkon me nivelin aktual të ofrimit të mallrave dhe shërbimeve publike, në të njëjtën sasi dhe cilësi.
 - Kostot e pafinancuara plotësisht të politikave të një programi buxhetor të cilat janë miratuar me akte ligjore ose akte nënligjore në vitet e mëparshme nuk përfshihen si pjesë e kostos së politikave ekzistuese për atë program.
 - Shpenzimet korrente për periudhën 2027-2029 nuk indeksohen me inflacionin në këtë fazë. Rishikimi i shpenzimeve korrente me inflacionin do të përcaktohet nga Ministria përgjegjëse për financat në fazën e ardhshme të përgatitjes së PBA.
 - Për shpenzimet kapitale, do të përfshihen në koston e politikave ekzistuese kostoja për zëvendësimin e aseteve dhe projektet në vazhdim, për të cilët ka një angazhim shumëvjeçar në përputhje me skedulin e implementimit të projektit.
 - Në rastin kur kostoja për financimin e politikave ekzistuese tejkalon tavanin indikativ të alokuar për programin buxhetor të njësisë së qeverisjes qendrore me 3%, pjesa e kostos së tejkaluar e detajuar në nivel programi/objekti/produkti do të paraqitet si pjesë e propozimeve për politika të reja.
 - Propozimet për politika krejtësisht të reja duhet të prioritarizohen nga njësi e qeverisjes qendrore sipas nivelit të rëndësisë dhe duhet:
 - i. T'i përmbahen prioritetëve të qeverisë;
 - ii. Të paraqiten të analizuara në aspektin teknik dhe ekonomik;
 - iii. Të argumentojnë impaktin social-ekonomik.
4. Të gjitha njësitë e Qeverisjes Qendrore, do të përgatisin kërkesa buxhetore për PBA 2027-2029, përmes sistemit AFMIS, dhe moduleve respektive të përgatitjes së PBA dhe PIM. Raportet e kërkesave buxhetore të gjeneruara përmes sistemit AFMIS do të dorëzohen zyrtarisht në Ministrinë përgjegjëse për financat.
5. Përgjashtimisht grupi 63 dhe grupi 87, duhet të përgatisin kërkesat buxhetore për PBA 2027-2029 sipas formateve excel dhe së bashku me relacionin shpjegues t'i përcjellin zyrtarisht brenda afateve të përcaktuara në këtë udhëzim, në hard copy në Ministrinë e Financave dhe elektronikisht në adresën: budget.programming@financa.gov.al.
6. Versioni i punës në sistemin SIMF (AFMIS) për fazën strategjike që do të zgjidhet nga ana juaj duhet të jetë ai i tavaneve indikative.
7. Kurset e Këmbimit për vitet 2020-2026 dhe parashikimi për vitet 2027-2029, që do të përdoren në planifikimin e shpenzimeve për projektet me financim të huaj, jepen si më poshtë:

Nr	Monedhat	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029
1	Kurs i këmbimit mesatar Lek/USD	108.6	103.5	113.0	100.6	93.1	88.3	88.3	88.3	88.3	88.3
2	Kurs i këmbimit mesatar Lek/EURO	123.8	122.5	119.0	108.8	100.7	98.3	98.3	98.3	98.3	98.3

8. Buxheti gjinor, ndryshimet klimaterike dhe përfshirja e shoqërisë civile në përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2027-2029

- a) Në zbatim të ligjit 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të udhëzimit të përbashkët nr.21, datë 21.06.2013 “Për përcaktimin e procedurave për integrimin gjinor në programin buxhetor afatmesëm”, të gjitha ministritë e linjës dhe institucionet e tjera buxhetore qendrore, duhet të kryejnë analiza me bazë gjinore të sektorit përkatës, me qëllim:
- a. përcaktimin e objektivave dhe treguesve të performancës me bazë gjinore, që ndihmojnë në kryerjen e analizave gjinore të sektorit përkatës dhe matjen e performancës së programit buxhetor.
 - b. detajimin e objektivave me bazë gjinore në produkte dhe kosto, të cilat synojnë zbutjen e pabarazive gjinore apo/dhe arritjen e barazisë gjinore, aty ku është e mundur.

Treguesit kyç të performancës me bazë gjinore dhe statistikën e nevojshme për përcaktimin e tyre, mund të konsultohen në link-un: <https://arkiva.financa.gov.al/manual-per-treguesit-kyc-te-performances-me-baze-gjinore/>

Për të realizuar me sukses buxhetimin gjinor nisur nga sa më sipër, Ministria përgjegjëse për financat, me asistencën e UN Women në Shqipëri, do të mbështesë EMP e programeve në procesin e draftimit të objektivave, treguesve kyç të performancës me bazë gjinore, produkteve dhe kostove që ndikojnë në avancimin e politikave të barazisë gjinore.

- b) të gjitha institucionet përgjegjëse të planifikojnë masa konkrete buxhetore zbutëse dhe përshtatëse për ndryshimet klimatike, në përputhje me planin kombëtar për energjinë dhe klimën, të shoqëruara me tregues të përshtatshëm dhe të matshëm performance, ku do të synohet që të identifikohet një ose disa produkte me kostot përkatëse që do të kontribuojnë në realizimin e tyre.
- c) Në kuadër të zbatimit të *Deklaratës së Ballkanit Perëndimor për Integrimin e Romëve, brenda Procesit të Zgjerimit të BE-së, firmosur në Samitin e Poznan, Korrik 2019, nga Kryeministrat e Rajonit*, si dhe, një buxheti sa më gjithëpërfshirës, të gjitha ministritë e linjës dhe institucionet qendrore që kanë programe buxhetore me politika të lidhura me integrimin e romëve dhe egjiptianëve këshillohen që në kërkesat e tyre buxhetore të evidentojnë dhe përfshijnë:
- a. Qëllime/Objektiva/Tregues performance dhe produkte të dedikuara për integrimin e romëve dhe Egjiptianëve;
- d) Në kuadër të buxhetimit me pjesëmarrje, në të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore, gjatë Fazës strategjike të përgatitjes së PBA 2027-2029, Titullari i njësisë së qeverisjes qendrore dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik, zhvillon në datat 29-30 Prill 2026, një takim konsultativ me përfaqësues të shoqërisë civile. Takimi thirret nga Koordinator i Grupit të Menaxhimit Strategjik, i cili të paktën 15 ditë para kryerjes së takimit:
- merr masat për njoftimin e mbledhjes dhe,
 - siguron që dokumenti paraprak i PBA-së, të jetë i disponueshëm për konsultim, nga të interesuarit.

Përfaqësuesit e Shoqërisë Civile në këtë takim do të njihen me objektivat politike, treguesit e performancës përkatëse dhe produktet e planifikuara në PBA 2027-2029, për çdo program buxhetor. Sugjerimet e përfaqësuesve të shoqërisë civile, së bashku me qëndrimet EMP-ve përkatëse lidhur me to (*pra EMP në çdo rast duhet të argumentojnë marrjen apo jo parasysh të sugjerimeve dhe pse*) duhet të jenë pjesë e një aneksi të veçantë, i cili do të dorëzohet në Ministrinë përgjegjëse për financat së bashku me kërkesat buxhetore të PBA. Me kërkesë të përfaqësuesve të Shoqërisë Civile, Ministria e Linjës, organizon edhe takime me anëtarë të EMP-ve të veçanta.

- e) Pas përfundimit të seancave dëgjimore të Fazës strategjike, Ministria përgjegjëse për financat gjithashtu, do të organizojë një takim konsultativ me përfaqësuesit e shoqërisë civile. Në këtë takim do të diskutohet propozimi për shpërndarjen e burimeve buxhetore në përputhje me politikat e programeve buxhetore për periudhën 2027-2029, me fokus qëndrimin e shoqërisë civile mbi këtë propozim. Takimi thirret nga Koordinator i Grupit të Menaxhimit Strategjik, i cili të paktën 15 ditë para kryerjes së takimit merr masat për njoftimin e mbledhjes.
- f) Minutat e këtij takimi së bashku me aneksin e dorëzuar nga Ministrinë e linjës (referojuni pikës c) do të reflektohen në një aneks të veçantë të dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029.

9. Afatet për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2027-2029

- a) Datat kryesore të Kalendarit të Menaxhimit të Shpenzimeve Publike për vitin 2026, të detyrueshme për t'u zbatuar për qëllim të këtij Udhëzimi, janë:
 - Afati për dorëzimin e Kërkesave të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 për **Fazën strategjike**, në të cilën përfshihen edhe propozimet për investimet publike, **është deri më datë 1 Maj 2026**;
 - Udhëzimi Plotësues i Përgatitjes së Buxhetit, duhet të shpërndahet tek Njësitë e Qeverisjes Qendrore pas miratimit të draftit të parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 nga Këshilli i Ministrave, brenda datës **10 Korrik 2026**;
 - Afati për dorëzimin e Kërkesave të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 për **Fazën teknike**, **është deri më datë 1 shtator 2026**;
 - Datat e seancave dëgjimore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029, për **Fazën strategjike**, paraqiten në **Tabelën nr.2**, bashkëlidhur këtij Udhëzimi. Në periudhat **18 Maj – 29 Maj 2026**, dhe **14 Shtator-25 Shtator 2026**, Ministria përgjegjëse për financat do të zhvillojë seancat dëgjimore me të gjithë anëtarët e Grupeve të Menaxhimit Strategjik të Njësisë të Qeverisjes Qendrore. Në këto seanca do të marrin pjesë gjithashtu, përfaqësues nga struktura përgjegjëse për planifikimin strategjik në Kryeministri dhe në Agjensinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Kordinimit të Ndihmës, struktura përgjegjëse për integrimin europian në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, si dhe një përfaqësues për çështjet gjinore nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në rolin këshillimor, gjatë të cilave do të diskutohen kërkesat për Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 të dërguara prej tyre. Në këto seanca do të jepen konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse, sipas fushave përkatëse nga përfaqësuesit e institucioneve të sipërcituara, të cilat do të përfshihen në raportin

përmbledhës të përgatitur nga Ministria përgjegjëse për financat, raport i cili u dërgohet zyrtarisht Njësive të Qeverisjes Qendrore.

- b) Ndëshkimet e parashikuara në nenin 71, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, do të zbatohen për nëpunësit autorizues në çdo rast të mundshëm të mosrespektimit të këtij udhëzimi.

10. Ndjekja e Procesit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 dhe Mbështetja Këshillimore

- Ministria përgjegjëse për financat do të organizojë në ambientet e saj takime me të gjithë Nëpunësit Autorizues të Njësive të Qeverisjes Qendrore për të diskutuar progresin dhe shqetësimet që mund të lindin gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit. Këto takime do të organizohen përkatësisht në datat:
 - ⇒ Takimi i parë, ditën e Premte, **datë 3 Prill 2026, ora 11:00;**
 - ⇒ Takimi i dytë, ditën e Premte, **datë 17 prill 2026, ora 11:00.**
- Ndjekja dhe zbatimi me përpikmëri e këtij Udhëzimi nga ana e Njësive të Qeverisjes Qendrore do të raportohet rregullisht nga ministri përgjegjës për financat në Këshillin e Ministrave.
- Të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore, krahas dorëzimit të kërkesave buxhetore në hard copy në Ministrinë përgjegjëse për financat brenda afateve të përcaktuara në këtë udhëzim, duhet t'i dërgojnë elektronikisht këto kërkesa dhe në adresën e e-mail: budget.programming@financa.gov.al.

MINISTRI

PETRIT MALAJ



